***REPUBLIKA E SHQIPERISE***

***DHOMA E NOTERISE TIRANE***

***REP NR.*** 2197 (Pullat e taksës shtetërore prej 700 lekë janë aplikuar në kopjen e noterit)

***KOL NR.*** 401

## *KONTRATE DHURIMI*

Sot ne Tirane, me date 31 Maj 2006, perpara meje Noterit Pirro Stefani u paraqiten palet si me poshte:

**DHURUESI:** Nikolaos Papadopoulos, i biri i Jorgos, dtl.1967 ne Selanik, Greqi, shtetas grek, posedues i leternjoftimit grek me nr. M 434666, i cili me poshte do te quhet *"Dhuruesi"*", dhe

**PRANUESI:** Arben Bylykbashi i biri i Selamit, dtl. 1969 lindur ne Bilisht, banues ne Tirane, posedues i pasaportes shqiptare me nr. 1575826, i cili me poshte do te quhet *"Pranuesi"*;

**OBJEKTI:** Shoqeria anonime "CLUB MUZIKOR" SH.A eshte rregjistruar ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendim nr. 21109, dt. 25.03.1999 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "CLUB MUZIKOR" SH A ."*Dhuruesi*" aksioner i shoqerise anonime "CLUB MUZIKOR" SH.A me 26% te kapitalit te shoqerise dhuron aksionet e tij aksionerit te po kesaj shoqerie z. Arben Bylykbashi dhe del nga shoqeria. Aksionet e "*Pranuesit*" pas ketij dhurimi arrijne ne 50% te kapitalit te shoqerise

Me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat identifikuese qe ata mbajne.

Ata me deklaruan se deshirojne te lidhin kete Kontrate Dhurimi me permbajtjen si me poshte vijon:

1. *"Dhuruesi"*, pas vendimit paraprak te Asamblese se Aksionereve te shoqerise "Club Muzikor sh.a", nr.3, dt. 25.05.2006, dhuron pjesen e aksioneve e tij prej 26% ne shoqerine anonime "CLUB MUZIKOR" SH.A. dhe del nga kjo shoqeri.

2. 26% (njezet e gjashte) te kapitalit aksionar te shoqerise i perkasin 26 aksione.

3. *"Pranuesi"* deklaron se i pranon dhe se bashku me aksionet, merr persiper detyrimet qe percaktohen ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e kesaj shoqerie.

4. *Pjesa e aksioneve qe i perkasin "Pranuesit"* pas kesaj Kontrate Dhurimi eshte 50% e kapitalit aksionar te shqerise anonime "CLUB MUZIKOR" SH.A.

5. Njoftimet apo kerkesat ose komunikim tjeter sipas dhe per arsye te kesaj Kontrate Dhurimi do te behet me shkrim.

Interpretimi dhe perkthimi nga gjuha shqipe ne ate greke u krye nga z. Ermir Hajdini, te cilin une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

Palet Kontraktuese pasi lexuan kete tekst, shprehin se Kontrata e Dhurimit eshte konform vullnetit te lire te tyre, dhe firmosin si me poshte une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

**PALET KONTRAKTUALE**

**"DHURUESI"**

**NIKOLAOS PAPADOPOULOS**

**"PRANUESI"**

**ARBEN BYLYKBASHI**

Arben Bylykbashi

**NOTER**

**PIRRO STEFANI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE PIRRO STEFANI NOTER TIRANE